

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “WINGS HELP” SH.P.K.

NENI 1 **KRIJIMI I SHOQËRISË**

1. Sot më datë **24/09**/2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “WINGS HELP” shpk, (Në vijim referuar si “Shoqëria”) nga ortaku me të dhëna si vijon:
 - **Alexandru-Mihai Iordanescu**, shtetas rumun, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal 502719450102;
 - **Baftjar Xhuti**, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal K00210027F;
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
3. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2 **FORMA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Asambleja e Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe këtij Statuti.

NENI 3 **EMËRTIMI**

1. Emërtimi i shoqërisë është **“WINGS HELP”** sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k.

NENI 4 **SELIA E SHOQERISË**

1. Shoqëria e ka selinë në adresën: Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga “Papa Kristo Negovani”, Pallati Lim-Em, Godina A, Kati 3, Ap. 10, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së selive sekondare, filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5 **KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.

1 | F a q e

2. Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë kur Asambleja e Ortakut të Vetëm e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :
 - Shërbime këshillimi dhe menaxhimi për aktivitetet tregtare.
 - Konsulencë për vete dhe të tretë në fushen e të drejtave të pasagjerëve ajrorë, tokesorë dhe detar.
 - Konsulencë dhe asisntence për vete dhe të tretë në lidhje me kompensimet e pasagjerëve sipas Rregullores Evropiane EC261/2004 si dhe Ligjit nr. 96/2020 „Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë“ dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij, për të drejtat e pasagjerëve dhe në shtete të tjera në rastet e vonesave, anulimeve dhe mohimit të imbarximit në fluturime, humbjes së bagazheve, etj.
 - Konsulencë, asistencë, përfaqësim, ndërmjetësim, dhe mbrojtje ligjore për sigurimin e kompesisimit financiar nga kompanitë ajrore për pasagjerët që gjenden në situatat si më sipër, përpara çdo entiteti dhe çdo shkalle të proceseve civile, administrative, gjyqësore në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.
2. Përveç aktivitetave të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Asambleja e Ortakut të Vetëm do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për te përbushur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.
3. Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licencë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jete marrë akti në fjalë.

NENI 7 **ORTAKËT DHE KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lek.
2. Shoqëria përbëhet nga ortakët me të dhënat e mëposhtme:
 - **Alexandru-Mihai Iordanescu**, shtetas rumun, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal 502719450102, zotërues i 1 (një) kuote, në vlerën 50.000 lekë, në masën 50% të kapitalit;
 - **Baftjar Xhuti**, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal K00210027F, zotërues i 1 (një) kuote, në vlerën 50.000 lekë, në masën 50% të kapitalit;
3. Pjesëmarrja e ortakëve në shoqëri është e paraqitur në mënyrë të përbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera	Përqindja %
1.	Alexandru-Mihai Iordanescu	1	50.000 lekë	50
	Baftjar Xhuti	1	50.000 lekë	50
TOTALI		2	100.000 lekë	100

4. Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme bazuar në nevojat e shoqërisë dhe konform parashikimeve ligjore.
5. Kapitali është shlyer tërësisht.

NENI 8
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
TË DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Ortakut të Vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet sipas ligit dhe statutit, por pa u kufizuar në:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
 - d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posacme;
 - l) Shpërndarjen e fitimeve;
 - m) Shndërrimin e formës se shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërish;
 - n) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në të thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë;
 - o) Miratimin në rastin e shitblerjes së koutave të ortakeve ose formave të tjera të transferimit të tyre, sipas parashikimeve të këtij statuti.

NENI 9
ADMINISTRATORI
EMËRIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Për efekt të këtij statuti, fjala „Administratori“ në njëjës, i referohet gjithashtu edhe së bashku apo veç e veç të dy administratorëve. Asambleja e Përgjithshme merr vendim të posaçem për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emëritimit të parë.
2. Administratori apo administratorët do të përfaqësojnë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë të gjithë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshire hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
3. Caktimi i Administratorëve të parë bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Përgjithshme. Administratorët të shoqërisë caktohen Alexandru-Mihai

Iordanescu mbajtës i kartës së identitetit me numër personal 502719450102 dhe Baftjar Xhuti mbajtës i letërnjoftimit me numër personal K00210027F

4. Administratorët, në ushtrimin e detyrave të tyre, do të veprojnë së bashku lidhur me ushtrimin e detyrave funksionale të tyre sipas këtij statutit, në raport me palë të treta.
5. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b. Përfaqësoje shoqërinë tregtare;
 - c. Hapë llogari bankare në emër të shoqërisë;
 - d. Përgatisë dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - e. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërise;
 - f. Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g. Raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
 - i. Të thërrasë asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose Ligji për shoqëritë tregtare.


NENI 10 **DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi apo në Statut që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas rregullave te përcaktuara, në perputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Caktohet administratori i shoqërisë ose një person i autorizuar prej këtij të fundit për regjistrimin fillestare të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT THEMELUES

ALEXANDRU IORDANESCU Mihai

Alexandru-Mihai Iordanescu



Baftjar Xhuti

Baftjar Xhuti

